



Qershor, 2021

Nr.6

### Takimi i dytë publik i ASHMA për 2021

Në kornizat e detyrimeve ligjore për mbajtjen e mbledhjeve publike, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale caktoi mbledhjen e dytë për 29 qershor 2021.

Qëllimi i këtyre takimeve është t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin pikëpamjet dhe mendimet e tyre në lidhje mbi situatën e tregut të shërbime mediatike audiovizive dhe të ndahen me publikun aktivitetet e realizuara të Agjencisë nga Programi Vjetor i punës Prezantimi dhe materialet me aktivitetet e realizuara të Agjencisë për periudhën prill-qershor 2021, janë në dispozicion në faqen e internetit [www.avmu.mk](http://www.avmu.mk)

### Mbikqyrje ndaj radiodifuzerëve, ORRPKE dhe mediat e shtypit

#### Radiodifuzerët

Mbikqyrje e rregullt programore dhe administrative për respektimin e dispozitave ligjore-publikimi i impresium shenjë për identifikimin e transmetuesve dhe informacione që duhet të vihen në dispozicion të përdoruesit, respektimin e rregullave për emitim e komunikimeve komerciale, emetimin e lojrave të fatit, shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik i bërë ndaj radiove „Rosa-AB“, „Zona M-1“, „RFM“, „Urban FM“ dhe „EF-EM 90.3 Sportsko radio“. Gjatë mbikqyrjes nuk u konstatuan shkelje.

Mbikqyrje e rregullt programore dhe administrative për rregullat për përdorimin e gjuhës në programet e transmetuesve, emetimin e përqindjes së raportuar vullnetarisht të muzikës vendore, emetimin ditor të paktën 18 orë program në radio, shpallje të impresiumit, informacione që duhet të jenë në dispozicion të përdoruesit dhe shpalljen e identifikimit të transmetuesit është kryer ndaj radiove „Jon“, „Metropolis“, „Antena 5“ dhe „Kanal 77“. Gjatë mbikqyrjes nuk u konstatuan shkelje të dispozitave LSHMAAV.

Mbikqyrje e rregullt programore është kryer ndaj „Makedonska televizija – shërbimi i parë (MRT 1)“, „TV 24 Vesti“, „TV Alfa“, „TV Alsat M“, „TV Klan Maqedoni“, „TV Kompani 21-M“, „Nasha TV“, „TV Kanal 5“, „TV Telma“, „TV Sitell“, „TV Shenja“ dhe „TV Sonce“, për obligimin më së pakti 51% (Servisin publik 60%) nga emetimi i përgjithshëm i programeve gjatë vitit për prodhimin e veprave audiovizive evropiane dhe nga buxheti i saj të veçojnë së paku 10% për vepra audiovizive evropiane nga producentët të pavarur, nga ku gjysma e tyre të jenë prodhuar në pesë vitet e fundit. Gjatë mbikqyrjes nuk u konstatuan shkelje. Janë kryer disa mbikqyrje kontrolli për të verifikuar nëse transmetuesit kanë vepruar sipas masave të lartëpërmendura-vërejtje publike. Ndaj „TV Alfa“, „TV Kompani 21-M“ dhe „Makedoska televizija – shërbimi i katërt programor (MRT 4)“ është kryer mbikqyrje e kontrollit programor për detyrimet e emetimit më së pakti 30% (Shërbim publik 40%) program popullor dhe për përdorimin e gjuhës në program. Nga mbikqyrja u konstatua se shërbimet programore kanë vepruar në përputhje me dispozitat ligjore. Ndaj „TV Klan Maqedoni“ dhe „Makedonska televizija – shërbimi i katërt programor (MRT4)“ është kryer mbikqyrje administrative për obligimin e shpalljes impresium, që tregoi se është vepruar në përputhje me dispozitat ligjore. Mbikqyrje e kontrollit programor është kryer dhe ndaj „TV Sitell“ dhe „TV Iris“ për detyrimin e mbrojtjes së publikut minorin. Nga mbikqyrja u konstatua se më 17 maj në programin e „TV Sitell“ është emetuar repriza e 169 episodeve nga seriali i luajtur „Angjeli“, në interval kohe të papërshtashëm dhe është kategorizuar jo drejtë si një program i kategorisë së dytë(+8). Sepse „TV Sitell“ pjesërisht veproi sipas Vendimit për marrjen e masave-vërejtje publike, ndaj saj është inicuar procedurë kundërvajtëse.

#### Operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike

Për detyrimet me të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin e shërbimeve programore të Agjencisë dhe titllimin e programeve që i ritransmetojnë operatorët, është kryer mbikqyrje e rregullt programore ndaj operatorëve „Neotel“, „Transped Trejd“, „Biv Piramida“, „Kabel“ dhe „Antena AS KTV“.

Nga mbikqyrja është konstatuar se operatori kabllorik „Kabel“ për përdoruesit e tij e ritransmeton shërbimi programor „BNT4“, operatori kabllorik „Antena AC KTV“ për përdoruesit e tij i ritransmeton shërbimet programore „Russia Today“ dhe „Russia Today Documentary“, që nuk janë të përfshira me kontratat për regjistrim në Agjencion..



## NEWSLETTER

### Mediat e shtypit

Ndaj 22 mediave të shtypit është realizuar mbikëqyrje administrative për obligimin e publikimit të impresumit. Në monitorim u përfshinë mediat e shtypit „Nova Makedonija“, „Sloboden Peçat“, „Veçer“, „Koha“, „Lajm“, „Fokus“, „M Magazin/Avto plus“, „Jeni Balkan Haftalig Bulten“, „Bahçe“, „Ekonomija dhe biznes“, „Ubavina i zdravje“, „Ruski doktor“, „Porta 3“, „Shenja“, „Skopsko eho“, „Zelena berza“, „Lice vlice“, „Zenit“, „Shtipski Glas“, „Bitolski Vesnik“, „Kapital“ dhe „Instore“. Monitorimi tregoi se obligimin ndaj Ligjit për media e kanë plotësuar të gjithë mediat e shtypit.

### Shqiptimi i masave- parajmërim publik

Këshilli i Agjencisë në seancën e 17-të e mbajtur me 9 qershor, në bazë të konstatimeve nga realizimi i monitorimit ku është konstatuar reemetim i serviseve programore të cilat nuk janë të regjistruar në Agjencinë në përputhje me nenin 141 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, solli Vendim për parajmërim publik dhe për ndërprejen e riemetimit të serviseve programore të operatorëve „Kabel“ nga strumica dhe „Antena AS KTV“ nga Kërçovo.

Në seancën e 18-të e mbajtur me 17 qershor, Këshilli i Agjencisë në bazë të konstatimeve nga realizimi i monitorimit ku është konstatuar se është realizuar ndryshimi i stukturës pronësore fillimisht pa mos e informuar Agjencinë dhe e nejtja të jetë e miratuar nga ana e Agjencisë, solli Vendim për marjen e masës-parajmërim publik për TV Nova nga Gjevgjelia.

